



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS
CENTAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

**RAPORTI I AKTIVITETEVE VJETORE
TË QKK-SË**

2015

INDEX

HYRJE	3
Aktivitetet e QKK-së.....	4
Berlinale 2015	5
Cannes 2015.....	6
LA Screenings.....	7
DOK Leipzig 2015.....	8
Konkursi 2015.....	9
Oscars 2015.....	12
Berlinale Preselection Zagreb.....	13
Promovimi Ndërkombëtar.....	13
Prezenca e QKK-së në festivalet tjera.....	15
Premierat	16
Festivalet dhe çmimet.....	17
Projektet në zhvillim.....	20
Sfidat dhe ngecjet.....	23
Plani për 2016.....	23

Hyrje

Qendra Kinematografike e Kosovës, institucioni qendror për kinematografi si çdo vit ka pasur aktivitete të shumta të cilat kanë ndikuar në ruajtjen e reputacionit në kinematografi si dhe kanë zhvilluar industrinë kosovare të filmit, QKK ka vazhduar prezentimin në festivalet më të mëdha me përkushtim shumë serioz në promovimin e filmave kosovar në tregjet e filmit si Berlinale, Cannes, American Film Market etj.

Këtë vit që po e përcjellim e karakterizojnë shumë të arritura. Në fillim vit na ka gëzuar pjesmarrja e filmit të mbështetur nga QKK, 'Burrnesha' e cila u dha premierë në njërin ndër festivalet më prestigjioze në botë, në Berlinale, duke futur Kosovën për herë të parë në konkurrencë zyrtare me shtetet më të mëdha të botës.

Ky film pas shfaqjes në Berlinale vazhdon të ketë një rrugë të gjatë në festivalet e tjera duke renditur shumë e shumë çmime ndërkombëtare.

Edhe këtë vit Kosova u prezentua në festivalin e madh europian Karlovy Vary ku u shfaq filmi 'Babai' me skenar dhe regji nga Visar Morina i cili shkoj në Çeki me 4 çmime që i fitoi në premierën europiane në FilmFest Munchen dhe me kaq nuk u ndal pa rrëmbyer edhe dy çmime në Karlovy Vary, njërin 'Regjisori më i mirë'. Por rruga e këtij filmi nuk u ndal me aq, ky film vazhdoi sukseset e mëtutjeshme dhe u zgjodh nga komiteti selektues si propozimi i Kosovës në Akademinë Oscars. Ky ishte viti i dytë prej kur Kosova fitoi të drejtën për propozim për nominim në kategorinë e 'Filmit më të mirë të huaj'.

Sukses të jashtëzakonshëm pati edhe filmi i shkurtër 'Shok' nga Jaime Donoghue i cili pati premierën në Mars 2015 në Aspen Shortsfest, pjesë e konkurrencës zyrtare nga i cili festival doli me 3 çmime dhe pastaj vazhdoi shfaqjen në shumë festivale, si rezultat ky film është në listën e ngushtë për nominim në Oscars në kategorinë 'Best Live Action Short Film'.

Aktivitetet e Qendrës Kinematografike të Kosovës

Qendra Kinematografike e Kosovës, me përkushtim ka punuar në promovimin, subvencionimin dhe mbështetjen e kineastëve, filmbërësve dhe personave të tjerë që merren me kinematografi.

Qendra Kinematografike e Kosovës sivjet ka marrë pjesë në festivale rajonale dhe ndërkombëtare duke qenë prezent me stenda dhe prezantime të filmave në konkurrencat zyrtare dhe programe speciale.

Këtë vit prezentimi i kinematografisë kosovare ka qenë në kulmin e saj duke bërë që filmat kosovar të shfaqen dhe të fitojnë çmime anë e kënd botës.

Në anën tjetër QKK me ngulm ka vazhduar promovimin e projekteve filmike, përfaqësimin e tyre dhe ka kontribuar në thellimin e bashkëpunimeve me vendet e rajonit dhe botën.



**QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS
CENTAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER**

BERLINALE 2015

Aktivitetet e QKK-së në vitin 2015 filluan me pjesëmarrjen në festivalin e madh Berlin International Film Festival, në njërën ndër tregjet më të mëdha të filmit. Kjo është hera e katërt që QKK është e pranishme me stendë, ndërsa këtë vit e karakterizoj bashkimi me QKK-në e Shqipërisë të cilët ndajten një hapësirë të përbashkët të promovimit.

Në European Film Market edhe këtë vit janë prezentuar dhe promovuar filmat kosovar përkatësisht industria e filmit në Kosovë, projektet që janë financuar nga QKK dhe që janë në faza të ndryshme të zhvillimit, duke përfshi filmat në paraproduksion, filmat në produksion, filmat në postproduksion, filmat e përfunduar si dhe filmat që kanë pasur premierën.

Këtë vit për herë të parë Kosova ishte me premierë në **Berlinalë** ku filmi **“Burrnesha”** ishte në konkurrencë zyrtare, film ky i mbështetur nga QKK që i cili futi Kosovën për herë të parë në garë me vendet më të mëdha të botës.



CANNES 2015

QKK për herë të katërt morri pjesë me stendë në festivalin prestigjioz të filmit Cannes 2015 ku edhe këtu Kosova dhe Shqipëria ishin në një stendë të përbashkët.

Në këtë festival u promovuan projektet më të fundit filmike si dhe u mbajtën takime të rëndësishme me producentë të ndryshëm, me përfaqësues nga fondet e filmit dhe si rezultat u arrit **marrëveshja me Sarajevo Film Festival**.

Si rezultat i kësaj marrëveshje pesë studentë nga Kosova patën mundësinë të përcjellin festivalin më të madh të Europës Juglindore. Ata ishin pjesë e një programi special në Festivalin e Filmit të Sarajevës ku gjatë qëndrimit të tyre shikuan filma, përcjellën ligjerata dhe shkëmbyen kontaktet dhe idetë me kolegët nga rajoni.

Marrëveshja u finalizua nga drejtori i festivalit të Sarajevës Z. Mirsad Purivatra dhe drejtori i QKK-së Z. Arben Zharku.

Gjatë qëndrimit në Cannes, QKK organizoj një koktej rasti ku u mblodhën të gjithë përfaqësuesit e fondeve të filmit dhe filmbërësit.




LA Screenings

Filmi **'Babai'** me skenar dhe regji nga Visar Morina u shfaq në **LA Screenings për Oscars.**

Këtë vit European Film Promotion u fokusua në shfaqjen dhe promovimin e 27 filmave evropian që kanë aplikuar për Akademinë Oscars.

QKK nën ombrellën e European Film Promotions ishte prezente me stendë. Në mesin e 27 filmave që u shfaqën ishte edhe 'Babai' propozimi i Kosovës për Oscars në filmin më të mirë të huaj. Prezent ishte edhe drejtori i QKK-së z. Arben Zharku dhe gjatë qëndrimit aty u organizua edhe një koktej rasti për shënimin e sukseseve të filmit 'Babai'.

Aty u shfaq edhe filmi **'Bota'** nga Iris Elezi dhe Thomas Logoreci i mbështetur nga QKK, e që ishte propozimi i Shqipërisë për Oscars.



DOK Leipzig 2015

Pjesë e aktiviteteve të Qendrës ka qenë edhe promovimi i filmave dokumentar në njërin nga festivalet më të mëdha të dokumentarit DOK Leipzig në Gjermani. Pjesë e këtij festivali është promovimi i katalogëve South East European Documentaries ku janë të gjithë filmat dokumentar që janë në proces të realizimit. Kosova aty promovoi këta filma: “Trapped by Law” nga Sami Musatafa, “Ushtarët Paralel” nga Mathieu Jouffre, “People of Baushtelle” nga Ilir Hasanaj, “The Last Battle of 20th Century” nga Dardan Islami, “Women from Gjakova” nga Shkurte Dauti dhe Gazmend Bajri, ‘Msitnia’ nga Dren Berisha dhe Genc Mehmetaj, “Njihuni me Enver Hadrin” nga Gilles Coton, “Hakmarrja” nga Marija Zidar, “Tregimi i tregimtarit” nga Gazmend Avdiu, “Kangë e defa” nga Fatime Kosumi dhe “Rrëfimet e emigrantit” nga Gazmir Lame.



Konkursi 2015

Konkursi i vitit 2015 pati dy juri. Jurinë për konkursin e filmave të metrazhit të gjatë dhe jurinë për konkurset e filmit të metrazhit të shkurtër, filmit dokumentar, filmit të metrazhit të gjatë debutant, filmit të animuar dhe për zhvillim skenari.

Juria e konkursit për film të metrazhit të gjatë u përbë nga: **Fjolla Hoxha- Kryesuese, Brendan Ward, Jean-Yves Roubin, Ndricim Xhepa, Kujtim Rrahmani, Gjergj Xhuvani, Sylejman Kllokoqi -në mungesë.**

Ndërsa juria e konkurseve të cekura më lartë ishte e përbërë nga: **Imer Mushkolaj – Kryesues, Arben Bajraktaraj, Eqrem Basha, Jahi Jahiu, Rebeka Qena, Hazir Haziri, Yll Citaku.**

Kësisoj, juria pas prezantimeve të projekteve aplikuese mbështeti 17 projekte filmike.

Projektet fituese në konkursin për film të metrazhit të gjatë ishin:

1. **“Shpia”**, skenari dhe regjia: Lendita Zeqiraj, me producent Bujar Kabashi.
2. **“Vera e andrron detin”**, skenari: Doruntina Basha, regjia: Kaltrina Krasniqi me producent Shkumbin Istrefi.
3. **“Njeriu i Dosjeve”**, skenari: Arian Krasniqi dhe Ismet Sijarina, regjia: Ismet Sijarina me producent Arian Krasniqi.



Për koproduksion minor, juria vlerësuese propozoi të mbështes projektin:

4. **“Freedom or Die”**, skenari dhe regjia: Vladimir Blazefski me producent Agon Uka.

Ndërsa juria vlerësuese për film të metrazhit të gjatë – debutant, zhvillim skenari, metrazhit të shkurtër, dokumentar dhe animacion propozuan të mbështesin këto projekte:

Për film të metrazhit të gjatë debutant juria vlerësuese propozoi të mbështes projektet: 1. **“Vdekja e Hakiut”**, skenari dhe regjia Anton Nrecaj, me producent Adriatik Kelmendi.

2. **“Një tregim Prishtine”**, skenari: Getoarë Mulliqi, regjia Burbuqe Berisha, me producent Agron Vula.

3. **“Gjumi dhe Dashuri”**, skenari dhe regjia Arsim Haliti me producent Valon Bujupi.

Për zhvillim skenari, juria vlerësuese propozoi të mbështes projektet: 1. **“Zana”**, skenari dhe regjia: Antoneta Kastrati, me producent Sevdije Kastrati & Casey Cooper Johnson.

2. **“Deri në fund”**, skenari: Astrit Kabashi, regjia: Valter Lucaj, me producent Liridon Cahani.

3. **“Gjakmarrja”**, skenari dhe regjia: Marija Zidar, me producent Latif Hasolli.

4. **“Zgjoji”**, skenari dhe regjia: Blerta Basholli, me producent Yllka Gashi.

Për film të metrazhit të shkurtër juria vlerësuese propozoi të mbështes projektin:

1. **“Home”**, skenari dhe regjia: More Raca, me producent Sunaj Raca.



Për film dokumentar juria vlerësuese propozoi të mbështes projektet:

1. **“Njihuni me Enver Hadrin”**, skenari dhe regjia: Gilles Coton, me producent Yll Uka.
2. **“People of Baushtellë”**, skenari dhe regjia: Ilir Hasanaj, me producent Rina Kika.
3. **“Msitnia”**, skenari: Genc Mehmetaj, regjia: Genc Mehmetaj & Dren Berisha, me producent Kastriot Jahaj.
4. **“Tregimi i tregimtarit”**, skenari dhe regjia: Gazmend Avdiu, me producent Gëzim Avdiu.

Për film të animuar juria vlerësuese propozoi të mbështes projektin:

1. **“Clara”**, skenari: Dafina Syla, regjia: Valë Blakqori, me producent Ilir Blakqori.



Oscars 2015

Viti 2015 ishte viti i dytë që kur Kosova fitoi të drejtën e propozimit të filmit kosovar për nominim në Akademinë Oscars. Vitin e kaluar nga komiteti selektues u zgjodh filmi “Tri Dritare dhe një Varje” me skenar nga Zymber Kelmendi dhe regji nga Isa Qosja.

Ndërsa këtë vit në komitetin selektues ishin: **Arben Bajraktaraj (kryesues), Ilire Vinca, Alban Muja, Sevdije Kastrati, Shkumbin Istrefi, Zymber Kelmendi dhe Blerta Zeqiri.**

Dy filma gjithsej kanë aplikuar për propozim filmi “**Azemi**” nga Rrahman Fetahu dhe “**Babai**” nga Visar Morina, ku komiteti vendosi që propozimi i Kosovës për Oscars të jetë filmi “Babai”.

Filmi ‘**Babai**’ nuk arriti të nominohet për **Oscars** mirëpo filmi i shkurtër ‘**Shok**’ është në listën e ngushtë të nominimit për Best Live Action Short Film në Oscars, nominim ky që i ka ardhur për shkak të festivaleve ku është shfaq dhe çmimeve që i ka fituar.



Berlinale Preselection Zagreb

Viti 2015 ka qenë viti i dytë që QKK ka dërguar filmat kosovar për Berlinale Preselection. Këtë vit ky organizim është mbajtur në Zagreb të Kroacisë, ku prodhimet më të reja filmike janë shfaqur duke synuar pjesëmarrjen në edicionin e 66-të të Berlin International Film Festival, i cili është një nga festivalet më të mëdha në botë.

Bashkë me filmat nga rajoni u shfaqen edhe 10 filma kosovar. Filmat e metrazhit të gjatë që u prezentuan në Zagreb janë: **“Home Sweet Home”** me skenar nga Zymber Kelmendi dhe regji nga Faton Bajraktari, **“Eho e Heshtur”** me skenar dhe regji nga Dren Zherka dhe **“Engjujt janë larg”** me skenar dhe regji nga Gjergj Xhuvani. Ndërsa filmat e shkurtër janë: **“Fjala”** me skenar nga Besian Hysaj dhe regji nga Ujkan Hysaj, **“Treni”** me skenar nga Selmon Beha dhe Jeton Rushiti dhe regji nga Selmon Beha, **“Personazhi I”** me skenar dhe regji nga Naim Berisha si dhe **“Anestezion”** me skenar dhe regji nga Noar Sahiti.

Gjithashtu edhe 3 filma të animuar u shfaqen: **“Alone”** nga Jeton Lakna, **“Ncuk, Ncuk, Ncuk”** nga Visar Arifaj dhe **“Përtej”** nga Nexhat Krasniqi.



Promovimi Ndërkombëtar

QKK së bashku me Cineuropa kanë arritur në një marrëveshje për promovimin e filmave kosovar në botë përmes Newsletters të cilat Cineuropa ka marr përsipër t'i shpërndaj.

Cineuropa është magazina më e madhe e industrisë të filmit, e cili i dha QKK vizibilitet të madh në botë. Nëpërmjet kompanisë Cineuropa e cila ka databazën më të madhe të industrisë të filmit në botë, ju shkojnë lajmet dhe të rejat e QKK-së por edhe lajmet nga industria e filmit në Kosovë. QKK përmes newsletter që dërgon çdo muaj ishte e pranishme në të gjitha mediumet ndërkombëtare.

Gjithashtu QKK me filmat që ka subvencionuar, gjatë vitit 2015 kanë zënë vend në medime ndërkombëtare si: **Hollywood Reporter, Screendaily, Variety, Indiewire, Cineuropa** etj.



Prezenca e QKK-së në festivalet tjera

QKK, ishte e pranishme në **Sofia Film Festival** pastaj në Istanbul Film Festival. Në Istanbul Film Festival, drejtori i QKK-së, z. Arben Zharku ka qenë një ndër panelistët e diskutimit të titulluar **“Meet the funds”**, në edicionin e 34-të këtij festivali. QKK, gjithashtu mori pjesë në Tribeca Film Festival, pastaj në Karlovy Vary.

QKK u prezentua edhe në Montenegro Film Festival, gjithashtu drejtori i QKK-së mori pjesë në tryezën e rrumbullakët për kinematografinë e shteteve të rajonit në Herceg Novi të Malit të Zi.

Drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës z. Arben Zharku ishte në juri në edicionin e 21-të të **Sarajevo Film Festival** që njihet si një nga festivalet më të mëdha në Ballkan.

Arben Zharku dhe David Gonzalez, i cili është redaktor në portalin ‘Cineuropa,’ portal ky që i dedikohet tërësisht kinemasë evropiane, ishin në jurinë që ndajten çmimin Cineuropa Award.

Në tetor u mbajt Java e filmit në Kosovë – **Bekim Fehmiu** e organizuar nga festivali ‘Mirëdita, dobar dan’ dhe inspiruar nga veprimtaria artistike e Bekim Fehmiut që për qëllim pati t’i sjell filmat e këtij aktori të madh shqiptar.

Kjo javë u organizua në bashkëpunim me QKK, Kino ABC, Dokukino, KTV, Sarajevo Film Center dhe Center Film.



Premierat

- Filmi **“Burrnesha”** nga Laura Bispuri ka pasur premierën botërore në Berlin International Film Festival.
- Filmi **“Babai”** nga Visar Morina ka pasur premierën në FilmFest Munchen dhe Karlovy Vary Film Festival.
- Filmi **“Krom”** nga Bujar Alimani pati premierën në Karlovy Vary Film Festival.
- Filmi **“Three Days in September”** nga Darijan Pejovski pati premierën në Montreal World Film Festival.
- Filmi i shkurtër **“Shok”** nga Jaime Donoghue pati premierën në Aspen Shortsfest.
- Filmi **“Cheers”** nga Norikë Sefa ka pasur premierën në DokuFest të Prizrenit.
- Filmi **“Çlirimi”** nga Burim Haliti pati premierën në Dokufest 2015.
- Filmi **“Të Pafajshmit”** nga Amir Vitija poashtu u shfaq për herë të parë përpara publikut në Dokufest.
- Filmi i studentit Durim Kryeziu **“Sonata”** pati premierën në Balkan Film Food Festival në qytetin e Pogradecit.
- Filmi i studentit Fisnik Muji **“Dita e Pensionimit”** pati premierën në Dokufest të Prizrenit.
- Filmi i studentes Arbresha Rubovci **“Koordinatat”** pati premierën në Balkan Film Food Festival në Pogradec.
- Filmi i studentit Arbër Krasniqi **“Untold Story”** e pati premierën në Albanian Film Week në Amerikë.
- Filmi dokumentar **“Trapped by Law”** pati premierën botërore në Festivalin Ndërkombëtar të Filmi Jhlava në Republikën Çeke.
- Filmi **“Engjujt janë larg”** nga Gjergj Xhuvani pati premierën e mbyllur në Tiranë.

Festivalet dhe çmimet

Qendra Kinematografike e Kosovës këtë vit ka promovuar filmat dhe filmbërësit kosovar në rajon dhe botë, duke i përkrahur me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve, akomodimit dhe shpenzimet e transportit të filmave dhe materialeve të filmave.

Këtë vit e karakterizojnë sukseset e shumta të filmave kosovar të cilët u shfaqën në shumë e shumë festivale.

Filmi **'Babai'** me skenar dhe regji nga Visar Morina deri më tani është shfaqur në 35 festivale duke fituar **14 çmime** ndërkombëtare. Vlen të theksohet çmimet në FilmFest Munchen ku fitoi si 'Filmi më i mirë', 'Skenari më i mirë', "Aktori më i mirë (Astrit Kabashi & Val Maloku)" pastaj fitoi çmimin 'Regjia më e mirë' në festivalin e madh Karlovy Vary etj.

Sukses të madh ka treguar edhe filmi i shkurtër **'Shok'** i cili është edhe në listën e ngushtë për Oscars. Ky film me skenar dhe regji nga Jaime Donoghue dhe producent Eshref Durmishin numëron 17 festivale të filmit dhe **14 çmime** ndërkombëtare.

Gjithashtu sukses të jashtëzakonshëm ka treguar edhe filmi **"Burrnesha"** nga Laura Bispuri, film ky që pati premierën në Berlinale dhe që vazhdoj një rrugë të gjatë në festivalet ndërkombëtare ku deri tani ka marr pjesë në 62 festivale dhe ka mbledhur mbi **25 çmime**.



Sukses treguan edhe filmi **“Krom”** me skenar dhe regji nga Bujar Alimani, **“Three Days in September”** nga Darijan Pejovski si dhe filmi i shkurtër **“Cheers”** nga Norikë Sefa, film ky që fitoi **dy çmime** në TIFF.

Sukses të mëtutjeshëm ka pasur edhe filmi **“Ballkoni”** i cili për herë të parë është prezentuar në vitin 2013 në Venice Film Festival në Itali. Ky film me skenar dhe regji nga Lendita Zeqiraj prodhim i shtëpisë filmike n’Art ka vazhduar rrugëtimin në festivale ku deri tash është shfaqur në 140 festivale duke numëruar **33 çmime**. Ky film në fillimvit është blerë nga distributori francez “Premium Films”, me të cilin është nënshkruar një kontratë pesë vjeçare.

Filmi **“Tri Dritare dhe një Varje”** poashtu është shfaqur në shumë festivale, ku vitin e ka nisur në Gothenburg Film Festival pastaj në Palm Springs International Film Festival, ka fituar çmimin e kritikës në festivalin e Luksemburgut e kështu me rradhë.

‘Bota’ nga Iris Elezi dhe Thomas Logoreci është shfaqur në 24 vende të botës dhe ka marr pas vetes rreth **12 çmime** ndërkombëtare duke vazhduar kështu rrugëtimin e saj në festivalet tjera.

Filmi **“Agnus Dei”** nga Agim Sopi ka vazhduar të shfaqet në festival, ky film deri tani numëron mbi **50 çmime** ndërkombëtare pastaj filmi **“Heroi”** nga Luan Kryeziu gjithashtu është shfaqur në festivale të ndryshme dhe ka fituar rreth **15 çmime**.



Në total të këtyre filmave të subvencionuar nga QKK si “Babai”, “Burrnesha”, “Tri Dritare dhe një Varje” “Agnus Dei”, “Heroi” “Bota”, “Shok” “Ballkoni”, “Kanarinët e dinë”, “Kali”, “Cheers” etj. deri më tani së bashku kanë marr rreth 186 çmime ndërkombëtare.

Kosova për herë të parë është rekomanduar për nominim në **European Film Awards** me dy filma të propozuar. Filmi **BABAI** me skenar dhe regji nga Visar Morina dhe filmi **TRI DRITARE DHE NJE VARJE** me skenar nga Zymber Kelmendi dhe regji nga Isa Qosja .

Në festivalin **Dokufest** në vitin 2015 janë dhënë **6 premiera kombëtare të filmave të mbështetur nga QKK**, si: “Cheers” nga Norikë Sefa, “Çlirimi” nga Burim Haliti, “Shok” nga Jaime Donoghue, “Të Pafajshmit” nga Amir Vitija, “Kali” nga Alban Ukaj dhe Yll Çitaku si dhe filmi i studentit Fisnik Muji “Dita e Pensionimit. Në Dokufest triumfoi filmi “Të Pafajshmit” me çmimin “Filmi më i mirë në konkurrencën kombëtare”.

Këtë vit në edicionin e 4-të të **Javës së Filmit Shqiptar i cili mbahet në New York**, në mesin e 32 filmave që u shfaqen në kategori të ndryshme, 9 prej tyre ishin filma të mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Festivali u hap me filmin ‘Tri Dritare dhe një Varje’ nga Isa Qosja.

Filmat që u shfaqen në kategorinë e filmave të metrazhit të gjatë janë: ‘Tri Dritare dhe një Varje’ dhe ‘Bota’. Në filmat e metrazhit të shkurtër ndër të tjerë u shfaqen edhe ‘Çlirimi’ nga Burim Haliti, ‘Kali’ nga Alban Ukaj, ‘Shkurta’ nga Arzana Kraja

dhe filmat e studentëve, ‘Dita e pensionimit’ nga Fisnik Muji, ‘Sonata’ nga Durim Kryeziu, ‘Untold Story’ nga Arbër Krasniqi.

Në dokumentarët që u shfaqen ishte edhe dokumentari i mbështetur nga QKK, ‘Toka e Grave’ nga Orhan Kerkezi.

Ndërsa në **Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë** tre filma të mbështetur nga QKK-ja ishin fitues të edicionit të 13-të të këtij festivali. ‘Babai’ i Visar Morinës rrëmbeu çmimin kryesor të filmit më të mirë të gjatë si dhe çmimin e medias. ‘Special Mention’ iu nda filmit ‘Kali’ nga Alban Ukaj dhe Yll Çitaku.

Në kategorinë ‘Filmi më i Mirë Shqip’ në TIFF doli fitues filmi i shkurtër ‘Cheers’ nga Norika Sefa kurse aktori i ri që luan në këtë film, Andi Bajgora u shpërblye me ‘Special achievement in acting’ për dy filmat, “Cheers” dhe “Shok”.

Gjithashtu në festivalin e filmit të shkurtër **“Swikos” në Basel** të Zvicrës u shfaqen 3 filma të mbështetur nga QKK që edhe ishin në konkurrencë, filmat: ‘Kali’ nga Alban Ukaj dhe Yll Çitaku, “Kanarinët e dine” nga Kaltrina Krasniqi dhe ‘Shok’ nga Jaime Donoughue. ‘Filmi më i mirë’ dhe ‘Kamera më e mirë’ i takoi filmit “Shok”.

Projektet në zhvillim

Gjatë vitit 2015 kanë përfunduar xhirimet dhe janë të gatshëm për premierë rreth 20 filma të metrazheve të ndryshme ku disa prej tyre edhe kanë pasur premierën këtë vit.

Disa nga projektet që kanë përfunduar këtë vit janë: “Engjujt janë larg” me regji dhe skenar të Gjergj Xhuvanit, “Out of the deep” me regji dhe skenar Nonny Geften, “Three Days in September” me regji dhe skenar nga Darijan Pejovski, “Home Sweet Home” me skenar nga Zymber Kelmendi dhe regji nga Faton Bajraktari, “Eho e Heshtur” me skenar dhe regji nga Dren Zherka, “Kthimi” me skenar dhe regji nga Kastriot Abdyli, pastaj filmat dokumentar si “Trapped by Law” nga Sami Mustafa, “Kosova Dogs” nga Blerdi Malushi, “Shenjat e të Kaluarës” nga Muhamed Bytyqi etj.

Sa ju projekteve filmike të metrazhit të shkurtër që kanë përfunduar janë: “Shok” me regji dhe skenar të Jamie Donoughue, “Cheers” me regji dhe skenar nga Norikë Sefa, filmi “Clirimi” nga Burim Haliti, “Të Pafajshmit” nga Amir Vitija, filmi “Anestezion” me regji dhe skenar të Noar Sahitit, “Kutia” me skenar nga Naser Shatrolli dhe regji nga Eno Milkani, “Basti” me skenar nga Besian Hysaj dhe regji nga Ujkan Hysaj, “ONNSide” me skenar të Afrim Mucaj dhe regji të Valter Lucaj,





Shkurte Dauti dhe Gazmend Bajri, “People of Baushtelle” nga Ilir Hasanaj, “The Last Battle of 20th Century” nga Dardan Islami, “Njihuni me Enver Hadrin” nga Gilles Coton, “Hakmarrja” nga Marija Zidar.

Sa ju përket animacioneve në produksion janë: “Fija e barit në beton” nga Dritëro Mehmetaj, “N’kornizë” nga Gëzim Ramizi dhe “Clara” nga Ilir Blakçori.

“Treni” nga Selmon Beha, “Sonata” nga Durim Kryeziu, “Untold Story” nga Arbër Krasniqi, “Koordinatat” nga Arbersha Rubovci, “Përtej ditës dhe natës” nga Zgjim Terziqi, “Color of Life” nga More Raca, “Dita e Pensionimit” nga Fisnik Muji etj. Gjithashtu këtë vit janë përfunduar tri animacione të mbështetur nga QKK: “Alone” nga Jeton Lakna, “Përtej” nga Nexhat Krasniqi dhe “Ncuk, Ncuk, Ncuk” nga Visar Arifaj.

Projektet në Produksion

Ndërsa projektet e mbështetura nga QKK filmat e metrazhit të gjatë të cilat janë në rrugë drejtë realizimit të tyre janë: “Histori Maje Kulmi” nga Gazmend Nela, “Rooftop Sonata” nga Edon Rizvanolli, “Once Upon A time in Northern Kosova” nga Ekrem Rrahmani etj.

Dokumentarët që po punohen janë: “Ura” nga Valmira Hyseni, “Ushtarët Paralel” nga Mathieu Jouffre, “Gratë nga Gjakova” nga



Imazh nga filmi “Rooftop Sonata” me skenar dhe regji nga Edon Rizvanolli

Projektet në Paraproduksion

Filmat e metrazhit të gjatë të cilët janë në paraproduksion dhe pritët që së shpejti të fillojnë xhirimet janë: “Martesa” nga Blerta Zeqiri, “Fusha e Mëllenjave” nga Arzana Kraja, “Pranëverë e Paharruar në Fshatin e Harruar” nga Kushtrim Bekteshi, “Shpia” nga Lendita Zeqiraj, “Vera e andrron detin” nga Kaltrina Krasniqi, “Njeriu i Dosjeve” nga Ismet Sijarina, “Freedom or Die” nga Vladimir Balzevski etj. Gjithashtu edhe filmat debutant pritët që të xhirohen dhe të përfundojnë në 2016: “Vdekja e Hakiut” nga Anton Nrecaj, “Një tregim Prishtine” nga Burbuqe Berisha, “Gjumë dhe Dashuri” nga Arsim Haliti.

Filmat dokumentar të cilët pritët të fillojnë xhirimet janë: “Msitnia” nga Dren Berisha dhe Genc Mehmetaj, “Tregimi i tregimtarit” nga Gazmend Avdiu etj.

Filmi i shkurtër që pritët të përfundohet në 2016 është “Home” nga More Raça.



Imazh nga filmi “Martesa” nga Blerta Zeqiri



Imazh nga filmi dokumentar “Msitnia” nga Dren Berisha dhe Genc Mehmetaj

Sfidat dhe ngecjet

Gjatë vitit 2015 krahas sukseseve kemi hasur edhe në sfida dhe në ngecje të cilat na kanë përcjellur.

Sfida kryesore ka qenë mosrealizimi i planit për lehtësira financiare, si shkak i pritjes së përgjigjes për fillim të punës nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave. Ky projekt për lehtësira financiare është propozuar nga QKK dhe ky mbetet një ndër synimet për vitin 2016.

Ngecja tjetër në vitin 2015 ka qenë mosrealizimi i marrëveshjes me RTK, ku RTK deri më tani nuk e ka realizuar marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2014.

Sfidë tjetër ka qenë mosanëtarësimi i Kosovës në Euroimages, shkaku që Kosova ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, mirëpo ky mbetet në synimet tona ashtu sikurse synojmë anëtarësimin në organizatat e tjera me qëllim promovimi.

Plani për 2016

QKK në 2016 do të vazhdoj promovimin e filmave kosovar dhe do të jetë prezente në festivale prestigjioze siç janë: Festivalit i Filmit në Berlin, Cannes, Karlovy Vary, Tribeca Film Festival, Sarajevo Film Festival, Antalya Golden Orange Film Festival, Vilnius Film Festival etj. Poashtu do të vazhdoj mbështetjen e filmave të diplomës sipas marrëveshjes me Universitetin Hasan Prishtina – Fakultetin e Arteve etj.

Ndërsa në vitin 2016 QKK do të jetë nikoqire e organizimit të “A Sunday in the Country”, organizim ky nga Akademia e Filmit European (në të cilin QKK është patron) ku çdo vit një shtet është mikëpritës për një vikend ku mbledhen filmbërës nga bota dhe ekspert që zgjedhen nga kjo Akademi. Gjatë këtyre 4 ditëve aty do të flitet rreth filmit me ekspert të kësaj fushe. Në ‘A Sunday in the country’ zgjedhen 10-15 pjesëmarrës dhe ekspert që vijnë nga EFA dhe kjo përveç që promovon Kosovën si shtet i ri gjithashtu është shkëmbim njohurish i gjeneratave të ndryshme të kineastëve nga bota që kanë prejardhje të ndryshme kulturore. Këta mysafir do të kenë mundësinë të njihen nga afër me kinematografinë tonë.

Gjithashtu në fillim të vitit 2016 filmat e shkurtër të mbështetur nga QKK do të shfaqen në Klan Kosova TV dhe përshkak të shfaqjes para një publiku shumë të gjerë është mundësi shumë e mirë për promovimin e filmit dhe artistave.

Duke besuar në zhvillime edhe më të mëdha të industrisë së filmit kosovar për vitin 2016, QKK me kënaqësi paraqiti aktivitetet e vitit që po lëmë pas por që do të mbetet në kujtimet tona për sukseset e arritura

